

MENDIM PAKICE

Unë komisionere Xhensila Pine, relatore e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit Klerona Meçi, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit me arsyetimin si vijon:

A. Lidhur me vlerësimin e pasurisë

Mosdeklarimi i personave të lidhur në deklaratën *Vetting*

Bazuar në parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Sipas pikës 13 të nenit 3 të po këtij ligji, “person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, i përbërë nga çdo person i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit. Është qenia në certifikatën familjare për gjithë periudhën e rivlerësimit që përcakton rrethin e personave të lidhur që duhet të deklarojnë në kuptim të nenit 3, pika 13 dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.9.2016, subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit dhe familjarët të tjerë. Për efekt të këtij ligji, sipas dispozitave të cituara më sipër, prindërit dhe familjarët e subjektit të rivlerësimit, për shkak të qenies në të njëjtën certifikatë familjare konsiderohen persona të lidhur që kanë pasur detyrimin për të paraqitur deklaratën e pasurisë *Vetting* bashkë me dokumentacionin që justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre.

Ndarja e subjektit të rivlerësimit nga trangu familjar, në datën 24.10.2016, një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, dhe pas daljes së udhëzimit nr. ***, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, bazuar në legjisllacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit (nr. 11 vendimi, datë 28.3.2023), nuk i ka përjashtuar nga përgjegjësia ligjore për deklarimin e pasurive në deklaratën *Vetting* prindërit dhe familjarët, të cilët kanë qenë pjesë e certifikatës familjare në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Subjekti ka shmangur detyrimin për deklarim të pasurisë dhe të interesave privatë të personave të lidhur, mungesa e deklarimit të të cilëve ka pamundësuar Komisionin në drejtim të hetimit të pasurive, disa prej të cilave renditen si vijon:

- i) Pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit apartament banimi me sip. 83 m² e ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastër, në bazë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.10.2010, kundrejt çmimit 2.365.500 lekë.
- ii) Pasuria nr. ***, vol. *** f. ***, z. k. ***, e llojit garazh me sip. 32 m² e ndodhur në lagjen “18 Shtatori”, Gjirokastër; në bazë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.10.2010, kundrejt çmimit 912.000 lekë.
- iii) Pasuria nr. ***, e llojit truall me sip. 1160 m² e ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastër, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.2009 kundrejt çmimit të blerjes 13.920.000 lekë(shtetasi I. M. pronar në 50%).

- iv) Pasuria nr. *** vol., *** f. ***, z. k. ***, lagjja “****”, Gjirokastrë, me sip. 761 m², I. M. me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.6.2005, kundrejt çmimit 3.191.000 lekë.
- v) Pasuria e llojit hotel me sip. 400 m² e ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastrë, blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.4.2005, kundrejt çmimit 23.500.000 lekë (shtetasi I. M. pronar në 1/3 pjesë).
- vi) Pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit apartament me sip. 48 m² e ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastrë, regjistruar në emër të shtetasit I. M. në bazë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.2.2014, kundrejt çmimit 5.928.000 lekë.
- vii) Pasuria nr. ***, e llojit apartament me sip. 57 m², blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.3.2013, kundrejt çmimit 2.969.472 lekë.
- viii) Pasuri e llojit apartament, blerë me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.3.2013, nga blerësi I. M. kundrejt çmimit 2.969.472 lekë.
- ix) Pasuri e llojit dy apartamente me sipërfaqe 95 m²/secili, porositur me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2016. nga shtetasi I. M. kundrejt çmimit 105.500 euro.

Përveç sa më sipër, familjarët kanë pasur pasuri të luajtshme, automjete e likuiditete, ndaj subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting*, pasi ka shmangur nga deklarimi pasuritë e familjarëve të saj, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kishin detyrimin që të deklaronin interesat pasurorë në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Gjithashtu, sjellja e subjektit të rivlerësimit, duke ndryshuar certifikatën familjare pasi ka hyrë në fuqi ligji nr. 84/2016, pas daljes së udhëzimit nr. ***, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, tregon një veprim të paramenduar për shmangien nga deklarimi në procesin e rivlerësimit të familjarëve të saj, që bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet prej subjekteve të rivlerësimit.

Pasuritë e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting* janë apartamenti i banimit me sip. 102.6 m², me adresë pallatet “****”, Tiranë, me vlerë 79.500 euro, për të cilin subjekti ka deklaruar se apartamenti që ajo përdor është i blerë nga babai, si dhe automjeti tip “Mercedes-Benz”, blerë 3.500 euro, dhe kryer pagesa e doganës me vlerë 104.369 lekë, për të cilin subjekti ka deklaruar se është në pronësi të saj, por i blerë nga babai me të ardhurat e tij.

Në pyetësorin nr. 2, në lidhje me burimin e krijimit të pasurive të mësipërme, subjekti shpjegoi se: *“Burimi kanë qenë të ardhurat nga veprimtaria që lidhet me aktivitetin në fushat e biznesit dhe shitja e pasurive të paluajtshme të familjes, shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme në emër të bizneseve, të ardhura të tjera që lidhen me pagat e babait dhe anëtarëve të tjerë të familjes”*.

Lidhur me apartamentin e banimit me sip. 102.6 m², në Tiranë, në përdorim nga subjekti

Nga hetimi rezultoi se pagimi i vlerës 44.360 USD për shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k. u bë me transfertë bankare nga llogaria bankare në dollar në emër të babait të subjektit në Raiffeisen Bank. Te kjo llogari bankare në emër të babait të subjektit në Raiffeisen Bank rezultoi se në datën 27.7.2013 ishte transferuar nga babai i subjektit me konvertim shuma 166.980 USD dhe në vitin 2016 u krye transfertat me vlerë 44.360 USD për apartamentin e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave, të përdorura për pagimin e apartamentit, u analizuan të ardhurat familjare deri në datën 27.7.2013 në raport me shpenzimet familjare si në vijim.

Referuar dokumentacionit, rezulton se të ardhurat familjare paraqiten si në tabelën vijuese.

Përshkrimi	Vlera në Le
Të ardhurat nga mardh.e punësimit të shtetasit I.M. si Person Fizik për periudhën 6/1993-7/1995 (P Bruto mbi te cilen jane llog. sig)	51177
Të ardhura neto nga aktiviteti tregtar I.M. për periudhën 1993-1994, dokumentuar nga DRT Gjirokaster	324092
Të ardhurat nga mardh.e punësimit të shtetasit I.M. ne shoqerine *** shpk, për periudhën 4/1995-01/2023(P.Bruto mbi te cilal jme llog. sig)	574569
Të ardhurat nga mardh.e punësimit të shtetasit I.M. ne shoqerine *** shpk, për periudhën 2/2003-12/2011 (P.Bruto mbi te cilen jane llog. sig)	5610620
Të ardhurat nga mardh.e punësimit të shtetasit I.M. ne shoqerine *** shpk, për periudhën 1/2012-06/2013 (P.neto)	1438113
Të ardhura nga mardh.e punësimit shtetsëja H .M. ne shoqerine *** shpk, për periudhën 10/2009-06/2013 (P.neto)	966108
Të ardhura te dokumentuara/deklaruara nga dividente, per shtetasi I.M. per periudhen	2184000
Të ardhura nga pensioni gjyshit periudhën 03/2001-06/2013	771186
Të ardhura nga pensioni gjyshes për periudhen 03/2005-06/2013	658584
Total të ardhura/ të hyra financiare	12578449

Shpenzimet jetike sipas INSTAT-it (për personat sipas certifikatës së gjendjes civile) paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	Vlera në Le
Shpenzime minimale për konsum sipas jurisprudencës së KPA, për periudhën 1993-1999	195036
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën 2000-6/2013, për 6,7 dhe 8 persona	11608131
Total	11803167

Sa më sipër, për sa të ardhurat familjare deri në datën 27.7.2013, kur u depozitua shuma 166.980 USD, e cila u përdor si burim për apartamentin e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, rezultojnë të mjaftueshme vetëm për përballimin e shpenzimeve jetike dhe, për rrjedhojë, nuk provohet mundësia financiare e babait të subjektit për krijimin e shumës 166.980 USD, në datën 27.7.2013, përdorur për pagesën e apartamentit në shumën 44.360 USD në 2016.

Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, pretendoi marrjen në konsideratë të të ardhurave të realizuara nga babai i saj nga kontratat e kaparit (porosisë), duke i paraqitur si prova për burimin e të ardhurave të babait të saj.

Në analizë të përcaktimeve ligjore, këto kontrata kapari kanë pasur si objekt shitje/porosie pasuri të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe, si të tilla, të ardhurat e përfituara nga objekti i veprimtarisë së shoqërisë dhe për sa i përket përfitimeve të babait të subjektit mbi këto të ardhura si individ (ortak), ato kalojnë/transferohen dhe konsiderohen vetëm pas shpërndarjes së dividendit nga ana e shoqërisë dhe shlyerjes së detyrimeve përkatëse tatimore, fakt ky që nuk u provua nga subjekti i rivlerësimit.

Në analizë të pretendimeve të subjektit mbi të ardhurat nga kontratat e kaparit, ato analizuar lidhur me vlerat e huave, dhënë nga shtetasi I. M. shoqërive tregtare, rezultojnë shumë herë më të vogla se vlera e huave si vijon:

Referuar pasqyrave financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2013, evidentohet fakti se shuma e detyrimit të akumuluar të shoqërisë ndaj aksionerëve në datën 31.12.2013 është në vlerën 80.628.530 lekë dhe, në raport me përqindjen e kuotave të kapitalit (65%) huaja që shtetasi I. M. i ka dhënë shoqërisë është vlera 52.408.544 lekë.

Referuar pasqyrave financiare të shoqërisë “***” sh.p.k., shuma e detyrimit të akumuluar të shoqërisë ndaj aksionerëve deri në datën 31.12.2013 është pasqyruar në vlerën 120.235.981 lekë, prej të cilave në raport me përqindjen e kuotave të kapitalit, huaja që z. I. M. i ka dhënë kësaj shoqërie është në vlerën 60.117.990 lekë.

Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, pretendoi marrjen në konsideratë të të ardhurave të realizuara nga interesat e llogarive bankare të babait të saj si burim krijimi. Për sa referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank, kanë qenë të investuara nga babai i subjektit likuiditete në vlerën rreth 140.000.000 lekë, gjendje investimi në datën 31.12.2013, në emër të babait të subjektit, shtetasit I. M. , pranë Raiffeisen Invest, për të cilat nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit për vlerën e investuar, të ardhurat e përfituara nga interesat e investimit të këtyre likuiditeteve nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare për krijimin e pasurive të deklaruara.

Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, pretendoi marrjen në konsideratë të të ardhurave të realizuara nga gjyshi si bujk për periudhën e marrë në shqyrtim, në vlerën 5.732.040 (të ardhura nga blegtoria) + 1.460.000 (të ardhura nga shitja e bagëtive) = 7.192.040 lekë.

Si dokumentacion provues subjekti depozitoi deklaratën noteriale nr. 1008 rep., nr. 543 kol., datë 26.3.2024, të shtetasve T. M. dhe N. M.

Referuar qëndrimeve të Kolegjit, të ardhurat nga bujqësia e blegtoria mbeten vetëm në kuadrin deklarativ, nuk provohen për sa i përket vlerës e ushtrimit të aktivitetit. Deklarata noteriale, dhënë vetëm në kuadër të procesit të rivlerësimit për sa kohë nuk shoqërohet me dokumente të tjera, nuk ka fuqi provuese.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe rezulton se ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e paluajtshme në përdorim, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz”, në pronësi

Referuar informacionit dhe dokumentacionit rezulton se znj. Klerona Meçi ka blerë në datën 16.10.2016 nga shoqëria “****”, Gjermani, automjetin tip “Mercedes-Benz”, kundrejt çmimit 3.500 euro.

Në deklaratën doganore datë 21.10.2016, në cilësinë e marrësit/importuesit të këtij automjeti është subjekti i rivlerësimit. Me këtë deklaratë autoriteti doganor ka bërë rivlerësim të çmimit të blerjes së mjetit afro 2 herë më shumë nga çmimi i blerjes së deklaruar, ku janë shlyer detyrimet doganore në shumën 199.347 lekë. Sa më sipër, shuma e llogaritur/paguar nga subjekti/ rezulton në vlerën 678.427 lekë.

Në bazë të dokumentacionit të administruar, konkretisht, kartelës së regjistrimit të këtij automjeti në shtetin gjerman rezulton se në datën 19.10.2016 është lëshuar leje dhe targa provizore, në emër të shtetasit N. P., me adresë, Lagjja Nr. ***, ***, Sarandë.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se: “Z. P. N. në emër të të cilit është lëshuar leja dhe targa provizore është një mik i babait tim, i cili ka bërë blerjen e këtij automjeti

në Gjermani për llogari të babait tim dhe e ka sjellë këtë mjet në Shqipëri. Paratë për blerjen e mjetit i janë dhënë z. N. nga babai im, prandaj dhe kontrata në Gjermani dhe në vazhdim dhe zhdoganimi janë kryer në emrin tim”.

Në lidhje me burimin e të ardhurave

Në zbatim të udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se: “*Autovetura është blerë nga babai me të ardhurat e tij personale...*”.

Në pyetësorin nr. 2 në lidhje me burimin e krijimit, subjekti nuk ka bërë një përcaktim specifik të burimit të të ardhurave për blerjen e autoveturës, por e ka përfshirë në burimin financiar të paraqitur për blerjen e apartamentit në Tiranë, duke shpjeguar ndër të tjera se: “*...kanë qenë të ardhurat nga veprimtaria që lidhet me aktivitetin në fushat e biznesit dhe shitja e pasurive të paluajtshme të familjes, shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme në emër të bizneseve, të ardhura të tjera që lidhen me pagat e babait dhe anëtarëve të tjerë të familjes...*”.

Në vijim të analizës financiare të Komisionit për burimin e të ardhurave dhe mundësinë financiare të babait të subjektit për pagesën e kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit deri në datën 27.7.2013, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për pagimin e automjetit u analizuan të ardhurat familjare në raport me shpenzimet jetike të periudhës korrik 2013 – shtator 2016.

Për sa nga analiza financiare, të ardhurat familjare për periudhën korrik 2013 – shtator 2016 rezultojnë në vlerën rreth 3.385.000 lekë, ndërsa shpenzimet jetike të familjes për periudhën korrik 2013 – shtator 2016 rezultojnë në vlerën rreth 5.528.000 lekë (691.000 lekë për person, llogaritur për 8 personave referuar certifikatës familjare të datës 23.5.2014) nuk provohet mundësia financiare e subjektit për krijimin e pasurisë së luajtshme në pronësi të saj.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe rezulton se ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për pasurinë e luajtshme në pronësi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

B. Lidhur me vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ i kryer Komisioni u informua nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër se ndaj babai të subjektit, z. I. M. , shoqërisë “****” dhe një personi të tretë kishte regjistruar procedimin penal nr. ***, në vitin 2014, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Në datën 27.5.2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, pasi studioi aktet e procedimit penal nr. *, viti 2014, vendosi:**

1. Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen pranë Raiffeisen Bank në llogarinë bankare në emër të shtetasit I. M. e, konkretisht, në llogaritë bankare në lekë në shumat 5.132.607 dhe 16.043.773; në llogaritë bankare në euro në shumat 100.155.17 dhe 22.772.43; në llogarinë bankare në dollarë në shumën 57.490.76.

2. Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen në Raiffeisen Bank në llogaritë bankare në emër të shtetasit Artur Hitaj e, konkretisht, në llogarinë bankare në lekë në shumën 111.014

lekë; në llogarinë bankare në euro në shumën 10.000 euro; në llogarinë bankare në dollarë në shumën 100.000 USD.

3. Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen pranë Raiffeisen Bank në llogaritë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, konkretisht në llogarinë bankare në lekë në shumën 3.961.565,68 lekë. Në llogarinë bankare në euro në shumën 41.935.68 euro.

4. Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen pranë Raiffeisen Bank në llogaritë bankare në emër të kompanisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, konkretisht në llogarinë bankare në lekë në shumën 7.331.74, në llogarinë bankare në euro në shumën 82.40.

5. Lënien në ruajtje të vlerave të sipërcituara pranë Raiffeisen Bank deri në përfundim të hetimeve.

6. Me vendimin e mësipërm të njihen personat e interesuar që brenda 10 ditëve nga marrja dijani kanë të drejtën e ankimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Në datën 2.6.2014, ndaj këtij vendimi ka ushtruar të drejtën e ankimit shoqëritë “****” sh.p.k. (subjekti në këtë kohë mbante detyrën e juristes së kësaj shoqërie) e “****” sh.p.k., si dhe shtetasit I. M. dhe A. H.

Me vendimin nr. ***/***, datë 11.6.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka vendosur si vijon: të hiqet sekuestroja mbi llogaritë bankare në lekë në favor të shtetasit I. M. ; të hiqet sekuestroja mbi llogaritë bankare në lekë në favor të shtetasit A. H., të depozituar në Raiffeisen Bank; të hiqet sekuestroja mbi llogaritë bankare në lekë, euro, dollarë në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., të depozituar në Raiffeisen Bank; të hiqet sekuestroja mbi llogaritë bankare në lekë, euro, dollar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., depozituar në Raiffeisen Bank; të lihet në fuqi vendimi për sekuestron e vënë mbi llogaritë bankare personale në euro dhe dollar të shtetasve I. M. dhe A. H., në Raiffeisen Bank – vendim i cili *ka marrë formë të prerë në datën 23.6.2014.*

Nisur nga rrethanat dhe faktet e procedimit penal rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër në datën 27.5.2014, vendosi: Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodheshin pranë Raiffeisen Bank në llogaritë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., në lekë, në shumën 3.961.565.68 lekë dhe në euro në shumën 41.935,68.

Në deklaratën *Vetting*, në seksionin “Angazhime nga veprimtari private” rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka qenë e punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me funksion juriste nga data 21.4.2014 deri më 6.12.2015.

Pasi Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për detyrat që ka pasur në funksionin e juristes së shoqërisë “****” sh.p.k., ajo deklaroi se detyra funksionale e saj në këtë shoqëri ka qenë asistenca e përgjithshme juridike, që lidhej kryesisht me menaxhimin e përgjithshëm të kontratave dhe praktikave tregtare.

Në pyetësin nr. 2, subjekti ka deklaruar se: *“Në momentin e plotësimit të deklaratës nuk kam qenë në dijeni të faktit se ndaj babait tim ka pasur ndonjë procedim penal, pasi për shkak të moshës relativisht të re, babai nuk më ka vënë në dijeni në atë kohë. Për këtë fakt jam informuar nga im atë për shkak të pyetjes suaj. Nëse do kisha dijeni në momentin e plotësimit të deklaratave lidhur me procesin e rivlerësimit, do ta kisha deklaruar, pasi kam qenë dhe jam e vetëdijshme që është një fakt që nuk mund të fshihet”.*

Jo vetëm detyra funksionale e subjektit si juriste e shoqërisë “****” sh.p.k. nga data 21.4.2014 deri më 6.12.2015, e lidhur drejtpërdrejt me aspektin ligjor të veprimtarisë së shoqërisë, gjatë kohës së sekuestrimit të vlerave monetare që ndodheshin pranë Raiffeisen Bank në llogaritë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., por edhe vetë marrëdhënia e punësimit e subjektit si punëmarrëse e shoqërisë, punësim për të cilin subjektit për një periudhë të konsiderueshme kohe nuk i është kredituar llogaria “pagë”, për shkak se llogaritë e punëdhënësit kanë qenë të bllokuara, rrëzojnë pretendimet e subjektit për padijeninë lidhur me procedimin penal të babait dhe shoqërisë ku ajo ishte e punësuar.

Sa më sipër, subjekti gjatë hetimit administrativ ka bërë deklarime të pasakta lidhur me komponentin e figurës, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këndvështrimin e përgjithshëm ky konkluzion cënon shkallën e besueshmërisë së saj në zbatim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të procesit kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Klerona Meçi, pasi kam arritur në konkluzionin se:

- Subjekti i rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në pronësi e përdorim, si dhe gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3, dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e “d” të ligjit nr. 84/2016.
- Nga vlerësimi tërësor i kriterëve të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Xhensila PINE
Relatore (Kundër)